



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA**



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

“RËNDËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË FORMIMIN AKADEMIK”

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Ekipi i projektit:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina GISHTI (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI

Dr. Fjoralba DADO

Përshkrim i përgjithshëm i punës me aktivitetet e projektit në gjashtëmujorin e parë

Projekti me titull “*Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në formimin akademik*” u propozua në përgjigje të thirrjes për projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Urdhër të Ministrit Nr. 360 datë 28.06.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023 me shkresë Nr. 687 Prot., datë 08/07/2022 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Projekti "Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në formimin akademik" u propozua në vazhden e bashkëpunimit me Universitetin Sorbonne Paris Nord (USPN), në fushën e Inteligjencës Artificiale, specifikisht në Trajtimin Automatik të Gjuhëve si nëndegë e saj.

Projekti u shpall fitues me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 468, datë 02.08.2022 dhe me shkresën Nr. 2203/5 Prot., datë 05.08.2022 të UT-së.

Bazuar në kalendarin e aktiviteteve të projektit, pas shpalljes fitues u realizua aktiviteti: **Takimi koordinues i grupit të punës.**

Ky takim është shumë i rëndësishëm për të vendosur themelet për zbatimin e suksesshëm të kësaj nisme. Bazuar në ekspertizën dhe aftësitë e secilit anëtar të ekipit, u ndanë detyrat për të siguruar një ngarkesë të balancuar të punës dhe me qëllim që të shfrytëzohen pikat e forta të secilit anëtar të ekipit, për të maksimizuar efikasitetin.



Gjithashtu, më datë 12.12.2022 në aktivitetin “Dita e Kërkuesve Shkencorë” organizuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, grupi i punës së projektit bëri një prezantim të përgjithshëm të projektit dhe objektivave të tij përballë personelit akademik të FGJH si edhe studiuesve të rinj doktorantë e studentë të ciklit të dytë master.



Si pjesë e punës në aktivitetin 1 është dhe **ngirtja e ekipit të përbashkët për angazhim në programin master.**

Duke patur parasysh aspektin ndërdisiplinor të këtij projekti, grupi i ekspertëve përbëhet: nga profesorë nga Universiteti Sorbonne Paris Nord (USPN) dhe Universiteti i Tiranës (UT) të cilët do të mbulojnë të gjitha fushat e studimit të propozuara në masterin e dyfishtë; Në këtë fazë të parë, pedagogët e Universitetit të Tiranës janë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Ekonomisë si edhe stafi administrativ që do të përfshihet në procesin e implementimit të masterit.

Për realizimin sa më mirë të procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit, u gjykua e nevojshme **krijimi i një Laboratori Kërkimor** (i ngjashëm me atë në USPN) me logjistikën e duhur hardware dhe software.

Nga rezultati i ekspertizës nga pala franceze për kushtet pedagogjike dhe teknike në UT, u pa mungesa e një salle të dedikuar dhe platformat dhe software-ët e nevojshme.

Grupi i punës ka përcjellë menjëherë për zbatim projektin fitues për krijimin e infrastrukturës bashkëkohore dhe digjitale me ngritjen e laboratorit kërkimorë Trajtimi Automatik i Gjuhëve për t'u vënë në dispozicion kërkuesve të rinj shkencorë dhe studentëve të FGJH-së këtë hapësirë të

digjitalizuar me qëllim realizimin e kërkimit shkencor dhe procesin mësimor të masterit të dyfishtë. Laboratorët e ngritur kanë pajisje të reja si: kompjuter, laptopë, projektorë, tabelë interaktive si dhe pajisje të tjera të nevojshme për një funksionim sa më të mirë dhe efikas.

Në fund të vitit 2022 u realizuar ngritja e laboratorit kërkimor: **“Trajtimi Automatik i Gjuhëve”**. Ky laborator u përurua në një event të veçantë më datë 14.02.2023 me pjesëmarrjen e vecante te Ministrit te Arsimit dhe Sportit, Rektorit te UT-se dhe personelit akademik e studenteve te ciklit te trete doktrate dhe te ciklit te dyte master.

